



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:251346

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709999

KPPP.nr. 1912/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Lulishtja “Agonisi”, me numër unik identifikues 811307083 dhe seli në Rrugën Pejë - Deçan, kundër debitorit TDM – Global L.L.C., me numër unik identifikues 811581116 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valon Basha, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 250/23, i lejuar me datë 18.10.2023, nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit TDM – Global L.L.C., me numër unik identifikues 811581116 dhe seli në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 250/23, i lejuar me datë 18.10.2023, nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 250/23, i lejuar me datë 18.10.2023, nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 21-08-1/23, e datës 21.08.2023, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 250/23, të datës 18.10.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 3,891.00, me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se urdhri përmbarimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës e cila përmban një nënshkrim të pa lexueshëm dhe pa ndonjë emër të personit i cili ka nënshkruar, realisht e njëjta nuk është e pranuar nga debitori dhe nuk është vulosur nga i njëjti. Me tej, ka theksuar se fatura nuk i përmban as elementet e domosdoshme për t’u konsideruar si dokument i besueshëm pasi që nuk figuron data kur e njëjta është bërë e arritshme për apgesë. Ndërsa i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është e nënshkruar dhe në të njëjtën është i përcaktuar afati i përmbushjes së detyrimit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se përmbaruesi privat ka lejuar urdhrin përmbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 21-08-1/23, e datës 21.08.2023, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga

ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit se fatura objekt përmbarimi nuk është pranuar nga debitori, mirëpo të njejtat i gjeti si të pabazuara për arsye se fatura rezulton të jetë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar dhe nënshkruar nga debitori i cili, bazuar në shkresa të lëndës, ka bërë edhe pagesë të pjesshme në emër të kësaj fature. Rrjedhimisht, rezulton se debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen dhe lartësinë e detyrimit që buron nga fatura objekt përmbarimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njejtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1912/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.